



*Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)*



Fusha e zbatimit të Procedurës Evropiane për Paditë e Vogla (PEPV) dhe mekanizmi i ngjashëm sipas ligjit procedural shqiptar

Prof. Assoc. Flutura Kola Tafaj

Tiranë, 20-21 Shkurt 2021



*Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)*



1. Qëllimi i Rregullores 861/2007
2. Fusha e zbatimit të Rregullores 861/2007
3. Ndërveprimi me instrumente të tjerë evropian
4. Procedura e gjykimit
5. Gjykimi i padive për shuma të vogla sipas legjislacionit shqiptar



Qëllimi i Rregullores 861/2007

- Rregullorja 861/2007 përcakton një Procedurë Evropiane për Padi të Vogla (PEPV).
- **Qëllimi** i PEPV-s:
 - a. Lehtësimi i qasjes në drejtësi;
 - b. Thjeshtimi dhe përshpejtimi i procesit gjyqësor në lidhje me paditë e vogla në çështjet ndërkufitare (Recitali (1); (7); (8) dhe (36)
 - c. Ulja e kostove
 - d. Mjet alternativ ndaj procedurave ekzistuese sipas ligjeve të Shteteve Anëtare.
- GjED: “Qëllimi i saj është të mundësojë zgjidhjen e padive të vogla në rastet ndërkufitare në një mënyrë më të thjeshtë dhe më të shpejtë, ndërsa ul kostot.....” (GJED, *ZSE Energia vs RG* [C-627/17] f. 26-27)



Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)



- Preambul 9: Kjo Rregullore synon të promovojë të drejtat themelore dhe në mënyrë të vecantë parimet e njohura nga Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian. Gjykata ose tribunali duhet të respektojë të drejtën për një gjykim të drejtë dhe parimin e kontradiktoritetit, veçanërisht kur vendos në lidhje me nevojën për të caktuar një seance gjyqësore me praninë e palëve dhe në lidhje me mënyrat e marrjes së provave dhe shkallën në të cilën do të merren provat.”



*Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)*



Fusha e zbatimit të Rregullores

- A. Fusha e zbatimit në lidhje me objektin e padisë
- B. Fusha gjeografike e zbatimit të Rregullores
- C. Zbatueshmëria në kohë e Rregullores



A. Fusha e zbatimit në lidhje me objektin e padisë

- a. Cështje civile dhe tregtare
- b. Cështje monetare dhe jo-monetare
- c. Kërtime të kontestueshme dhe të pakontestueshme
- d. Paditë me vlerë deri në 5 000 EURO



a. **PEPV zbatohet për çështje civile dhe tregtare.**

- Për “**çështje civile dhe tregtare**” – nuk ka përkufizim në Rregullore;
- GjED: “*..termit "çështje civile dhe tregtare" nuk mund t'i lihet tërësisht në interpretim gjykatave të llojeve të ndryshme që ekzistojnë në cdo shtet. Koncepti në fjalë duhet të shikohet si **i pavarur dhe duhet të interpretohet së pari, sipas objektivave dhe skemës së Konventës dhe së dyti, sipas parimeve të përgjithshme që qëndrojnë në themel të sistemeve ligjore kombëtare si një e tërë (C-29/76 LTU Lufttransportunternehmen GmbH & Co KG v Eurocontrol, ECR 1976, 1541).***
- Sipas GjED-s: “dy elemente janë të rëndësishëm për të vendosur nëse një mosmarrëveshje është e një natyre civile dhe tregtare:
 1. lloji (lënda) i mosmarrëveshjes; dhe
 2. marrëdhënia midis palëve të përfshira.

[LTU, para. 4; Rüffer, para. 14; Préservatrice foncière TIARD, para. 21; ČEZ, para. 22, and Lechouritou and Others, para. 30]



- Neni 2(1): “.....[Rregullorja] nuk do të shtrihet, në vecanti, në të ardhurat, çështjet doganore ose administrative ose të përgjegjësisë së Shtetit për veprimet dhe mosveprimet gjatë ushtrimit të autoritetit shtetëror (*acta iure imperii*)
- Në lidhje me paditë që përfshijnë një autoritet publik, GjED shprehet se: “*një çështje nuk është "civile ose tregtare" kur ka të bëjë me një mosmarrëveshje midis një autoriteti publik dhe një personi privat kur i pari vepron në ushtrimin e pushtetit public (acta iure imperi).*”
[Apostolides vs Orams]
- GjED bën dallimin midis *acta iure imperii*, të cilat janë të përjashtuara nga nocioni i "çështjeve civile ose tregtare", dhe *acta iure gestionis*, të cilat përfshihen në një nocion të tillë.



- Shembuj nga praktika e GjED në lidhje me dallimin mes midis *acta iure imperii* dhe *acta iure gestionis*:
- Në çështje *Préservatrice foncière* (C-266/01), GjED shprehet se: "*çështje civile ose tregtare*" e përfshin një padi me të cilën një shtet kërkon të zbatohet kundër një personi privat, një kontratë garancie ligjore e cila është lidhur për të mundësuar një person të tretë të sigurojë një garanci të kërkuar dhe të përcaktuar nga ai Shtet, për aq sa marrëdhënia juridike midis kreditorit dhe garantuesit, sipas kontratës së garancisë, nuk përfshin ushtrimin nga shteti i kompetencave që shkojnë përtej atyre që ekzistojnë sipas rregullave të zbatueshme për marrëdhëniet midis individëve private."
- Në çështjen *Eurocontrol*, GjED u shpreh se "*një pretendim i një autoriteti publik, i bazuar në një traktat ndërkombëtar, për të rimarrë shpenzimet për përdorimin e pajisjeve dhe shërbimeve të saj kur një përdorim i tillë ishte i detyrueshëm dhe shpenzimet ishin përcaktuar në mënyrë të njëanshme nuk është çështje civile ose tregtare.*"



3. PEPV zbatohet për çështje monetare dhe jo-monetare

- **[# UEP zbatohet vetëm për çështje monetare]**
- Padi për pagim detyrimi monetar;
- Padi për dëme që mund të vijnë nga aksidente;
- Padi për dorëzim malli apo pasuri tjetër të luajtshme;
- Padi për përmbushje detyrimi kontraktor;
- Padi për pushimin ose për kërkimin e parandalimit të një veprim joligjor etj.

4. PEPV zbatohet për kërkime të kontestueshme dhe të pakontestueshme

- **[# UEP zbatohet vetëm për kërkime të pakontestueshme]**



5. PEPV zbatohet për paditë (dhe kundërpaditë) me vlerë deri në 5 000 EURO

- Koha e përlogaritjes së vlerës së padisë (ose kundërpadisë) do të jetë momenti kur kërkesëpadia merret nga gjykata ose tribunali me juridiksion.
- Në këtë vlerë përjashtohen të gjitha interesat, shpenzimet dhe disbursimet. Ky përjashtim nuk zbatohet kur objekti i padisë janë vetëm interesa.
- Vlera e padisë dhe e kundërpadisë nuk llogariten në mënyrë kumulative;
- Nëse kundërpadia e kalon limitin, e gjithë çështja (edhe padia) shqyrtohen në procedurë të zakonshme dhe jo PEPV;
- Nëse objekti i padisë është vlerë monetare, vlera e padisë është ajo shumë;
- Nëse objekti i padisë është jo-monetar, është e nevojshme t'i jepet një vlerë.



- **PEPV nuk zbatohet për çështjet që kanë të bëjnë me:**
 - a. statusin apo zotësinë juridike të individëve;
 - b. të drejtat pronësore që lindin nga një marrëdhënie martesore ose nga një marrëdhënie e cilësuar nga ligji I zbatueshëm si një marrëdhënie e tillë që ka pasoja të krahasueshme me martesën;
 - c. detyrimet që rrjedhin nga një marrëdhënie familjare, prindërimi, martese ose lidhje e afërt;
 - d. trashëgiminë testamentare dhe ligjore, duke përfshirë detyrimet që lindin për shkak të vdekjes;
 - e. falimentimin, procedurat në lidhje me likuidimin e shoqërive të falimentuara ose personave të tjerë juridikë, organizime gjyqësore, marrëveshje për pagimin e detyrimeve dhe procedurat analoge;
 - f. sigurimet shoqërore;
 - g. arbitrazhi;
 - h. e drejta e punës;
 - i. qiramarrjet e pasurive të paluajtshme, me përjashtim të veprimeve për pretendimet monetare; ose
 - j. shkeljet e privatësisë dhe të të drejtave në lidhje me personalitetin, përfshirë shpifjen. (N. 2 parag.2)



B. Fusha gjeografike e zbatimit të Rregullores

- a. Gjykatat zbatuese të PEPV janë ato të Shteteve Anëtare, përvec Danimarkës. (Preambul 38)
- b. PEPV zbatohet vetëm për çështjet ndërkufitare



a. PEPV do të zbatohet në çështjet ndërkufitare.

- Për qëllim të kësaj Rregulloreje, një çështje ndërkufitare është ajo në të cilën të paktën njëra nga palët ka vendbanimin ose vendqëndrimin e zakonshëm në një Shtet Anëtar të ndryshëm nga Shteti Anëtar i gjykatës së investuar.
- Momenti, që përcakton nëse një çështje është ndërkufitare apo jo, është data në të cilën kërkesëpapia (Forma A) merret nga gjykata ose tribunali që ka juridiksion.
- Paditësi & i Padituri – Vendbanim ose vendqëndrim në BE – Gjykata në BE
- Paditësi [Vendbanim ose vendqëndrim JO në BE] - I Padituri [Vendbanim ose vendqëndrim në BE] – Gjykata në BE
- Paditësi [Vendbanim ose vendqëndrim në BE-së] - I Padituri [Vendbanim ose vendqëndrim JO në BE]!!!!!! – Gjykata në BE



- Vendbanimi do të përcaktohet në përputhje me nenet 62 dhe 63 të Rregullores Nr. 1215/2012. (n. 3)
- Neni 62 “1. Në mënyrë që të përcaktohet nëse një palë e ka vendbanimin në Shtetin Anëtar, gjykatat e të cilit janë investuar për një çështje, gjykata do të zbatojë ligjin e saj të brendshëm. 2. Nëse një palë nuk e ka vendbanimin në Shtetin Anëtar, gjykatat e të cilit janë investuar për çështjen, atëherë, për të përcaktuar nëse pala është me vendbanim në një Shtet tjetër Anëtar, gjykata do të zbatojë ligjin e këtij Shteti Anëtar.”
- Neni 63: “1. Për qëllimet e kësaj Rregulloreje, një kompani ose person tjetër juridik ose shoqatë e personave fizikë ose juridikë është me vendbanim në vendin ku ka:
 - (a) selinë statutore, ose
 - (b) administratën qendrore, ose
 - (c) vendin kryesor të biznesit”



- *GJED: “Rregullorja e Bruselit është në parim e zbatueshme kur i padituri ka vendbanimin ose selinë e tij në një Shtet Kontraktues, edhe nëse paditësi është me vendbanim në një vend jo-anëtar. Përyjashtimisht, ky parim nuk zbatohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur një dispozitë e shprehur e Konventës parashikon që zbatimi i rregullit të juridiksionit varet nga vendbanimi i paditësit në një Shtet Kontraktues.....” [Group Josi Reinsurance Company SA vs Universal General Insurance Company (UGIC) (C-412/98)]*



- Neni 3: “Për qëllim të kësaj Rregulloreje, një çështje ndërkufitare është ajo në të cilën **të paktën njëra nga palët** ka vendbanimin ose vendqëndrimin e zakonshëm në një Shtet Anëtar të ndryshëm nga Shteti Anëtar i gjykatës së investuar.
- A përfshihet “Ndërhryësi” në termin “Palë” të përcaktuar në nenin 3 të Rregullores?
- A e bën çështjen ndërkufitare fakti që Ndërhryësi (Person i tretë) ka vendqëndrim të ndryshëm nga vendqëndrimi i Paditësit dhe të Paditurit?
- *GjED*: “Neni 3(1) i Rregullores Nr. 861/2007 nuk e përkufizon konceptin “palë”, dhe as ia referon atë ligjit të (22); Në këto kushte, konceptit “palë” duhet t’i bëhet një interpretim autonom dhe uniform sipas kuadrit ligjor të BE. (23); Nga skema e përgjithshme e Rregullores PEPV mund të konkludohet se **pjesëmarrja e palëve ndërhryëse** në mosmarrëveshjet që bien në fushën e zbatimit të kësaj Rregullore **nuk ishte parashikuar**. Ky vlerësim konfirmohet nga vetë qëllimi i PEPV. Preambulat 7 dhe 8, si dhe neni 1 i saj nënvizojnë faktin se qëllimi i PEPV, që është opsionale, është i trefishtë. Qëllimi i saj është të mundësojë zgjidhjen e padive të vogla në rastet ndërkufitare në një mënyrë më të thjeshtë dhe më të shpejtë, ndërsa ul kostot. Një objektiv i tillë nuk mund të arrihej nëse procedura e vendosur do të lejonte pjesëmarrjen e një personi të tretë, siç është një “ndërhryës” (GJED, *ZSE Energia vs RG* [C-627/17] 22.11.2018, parag. 26- 27)



- “Neni 3(1) i Rregullores 861/2007 duhet të interpretohet sipas kuptimit se koncepti “palë” i referohet vetëm Paditësit dhe të Paditurit në procedurën kryesore, dhe jo Ndërhyrësit....
- Nenet 2(1) dhe 3(1) të Rregullores 861/2007, duhet të interpretohet sipas kuptimit që një mosmarrëveshje si kjo e procesit kryesor, në të cilën Paditësi (kërkuesi) dhe I Padituri kanë vendbanimet ose vendqëndrimet e zakonshme në të njëjtin ShA që ndodhet dhe Gjykata e investuar nuk bie në fushën e zbatimit të kësaj Rregulloreje.”” (GJED, *ZSE Energia vs RG* [C-627/17] parag. 37)



C. Zbatueshmëria në kohë e Rregullores

- a. Rregullorja PEPV është e zbatueshme në të gjitha Shtetet Anëtare, përvec Danimarkës, që prej 1 janarit 2009.

- b. Një padi mund të ngrihet sipas kësaj procedure edhe nëse e drejta e padisë ka lindur para kësaj date, me kushtin që detyrimi mbi të cilin bazohet padia nuk është shuar ose afati i parashkrimit sipas ligjit të aplikueshëm në lidhje me atë padi nuk ka kaluar.



Ndërveprimi me instrumente të tjerë evropian

1. Rregullorja e Procedurës së Urdhrit Evropian të Pagesave (PUEP) No. 1896/2006.
2. Rregullorja “Mbi Juridiksionin dhe Njohjen e Ekzekutimin e Vendimeve në Cështjet Civile dhe Tregtare” Nr. 1215/2012 [*The Recast Brussels Regulation*]
3. Rregulloret Rome I dhe Rome II
4. Rregullorja për dorëzimin e dokumenteve Nr. 1393/2007
5. Rregullorja për Marrjen e Provave Nr. 1206/2001



- **Rregullorja e Procedurës së Urdhrit Evropian të Pagesave (PUEP) No. 1896/2006.**
- U mundëson kreditorëve që të mund të mbledhin (a) detyrime monetare, (b) të pakontestuara © vlerë e palimituar.
- “1. Nëse deklarata e kundërshtimit paraqitet brenda afatit të përcaktuar në Nenin 16 (2), procesi do të vazhdojë para gjykatave kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës, përveç nëse paditësi ka kërkuar shprehimisht që procesi të ndërpritet në atë rast. Procesi do të vazhdojë në përputhje me rregullat e:
 - (a) Procedurës Evropiane të Padive të Vogla të përcaktuara në Rregulloren (KE) Nr. 861/2007, nëse është e zbatueshme; ose
 - (b) çdo procedure civile kombëtare të përshtatshme.
- 2. Kur paditësi nuk ka treguar se cilën nga procedurat e renditura në pikat (a) dhe (b) të paragrafit 1 ai kërkon të zbatohet në procesin që pason në rast të një deklarate kundërshtimi ose kur paditësi ka kërkuar që Procedura Evropiane e Padive të Vogla siç përcaktohet në Rregulloren (KE) Nr. 861/2007 të zbatohet për një padi që nuk bie brenda fushës së asaj Rregulloreje, procesi do të transferohet në procesin civile të kombëtar përshtatshëm, përveç nëse paditësi ka kërkuar shprehimisht që një transferim i tillë të mos bëhet.” (n. 17 PUEP)




- **Rregullorja “Mbi Juridiksionin dhe Njohjen e Ekzekutimin e Vendimeve në Cështjet Civile dhe Tregtare” Nr. 1215/2012**
- Neni 3(2): “Vendbanimi do të përcaktohet në përputhje me nenet 62 dhe 63 të Rregullores (BE) Nr. 1215/2012 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit(1).”
- PEPV nuk përmban rregulla për juridiksionin. Neni 4 i Rregullores PEPV referon Formën A. Pika 4 e Formës A: Juridiksioni përcaktohet sipas rregullave të Rregullores Nr. 1215/2012.
- Po ashtu, kuptimi “cështje civile dhe tregtare”



*Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)*



- Rregulloret Rome I dhe Rome II janë të zbatueshme për përcaktimin e ligjit të aplikueshem në marrëdhënie kontraktore dhe jo-kontraktore;
- Rregullorja për Dorëzimin e Dokumenteve Nr. 1393/2007 & Rregullorja për Marrjen e Provave Nr. 1206/2001 janë të zbatueshme në mungesë të një parashikimi të posacëm nga Rregullorja mbi PEPV.





Procedura e gjykimit

1. Fillimi i PEPV

- Paditësi e fillon PEPV duke plotësuar Formularin standard të kërkespadi së A (Shtoja 1);
- Formulari i kërkesës duhet të përfshijë një përshkrim të provave, që mbështesin pretendimin dhe të shoqërohen, kur është e përshtatshme, nga çdo dokument përkatës.
- Standard i Formës A është i disponueshëm në të gjitha gjykatat dhe tribunalet përpara të cilave mund të fillojë PEPV, dhe është i mundësuar përmes faqeve kombëtare përkatëse të internetit.



- Formulari A depozitohet në gjykatë ose tribunalin **me juridiksion (dhe kompetencë)**:
 - a. drejtpërdrejt me postë ose
 - b. me ndonjë mjet tjetër komunikimi, të tilla si faks ose postë elektronike, e pranueshme për Shtetin Anëtar.
- Shtetet Anëtare do të informojnë Komisionin se cilat mjete komunikimi janë të pranueshme për qëllim të PEPV në përputhje me nenin 4. (n. 25(b))
- Komisioni e bën publikisht të disponueshëm këtë informacion.
- https://e-justice.europa.eu/content_small_claims-354-ie-en.do?member=1#a_104
- **Ex: France Article 25 1 (b) Means of communication**
- A request for institution of legal proceedings can be submitted to the court by post.
- Parties to a proceeding commenced under Regulation (EC) No 861/2007 establishing a European Small Claims Procedure can communicate with the courts by post.



- Duke qenë se PEPV është kryesisht procedurë me shkrim, të gjitha dokumentet/provat e nevojshme (fatura, vertetime bankare, korrespondenca të këmbjera mes palëve, foto etj) ku bazohet padia duhet të dërgohen njëkohësisht me Formen A (Claim Form)
- Kur një kërkesë është jashtë fushës së veprimit të Rregullores PEPV, gjykata ose tribunali informon Paditësin për këtë qëllim.
- Në qoftë se Paditësi nuk e tërheq padinë, gjykata ose tribunali do të procedojë me të në përputhje me ligjin procedural kombëtar të zbatueshëm në Shtetin Anëtar në të cilin zhvillohet procedura.



- Kur gjykata ose tribunali
- (a) e konsideron informacionin e dhënë nga paditësi si të papërshtatshëm ose
- (b) qartazi të pamjaftueshëm ose
- (c) nëse formulari i kërkesëpadisë nuk është plotësuar si duhet,
- **Ia kthen paditësit për t'i dhënë mundësinë që brenda një kohe të caktuar:**
 - i. të plotësojë ose korrigjojë kërkesëpadinë (Formën A) ose
 - ii. të sjelli informacion ose dokumente shtesë ose
 - iii. të heqi dorë nga gjykimi padisë
- Gjykata ose tribunali përdor Formularin standard B, siç përcaktohet në Aneksin II.



- Gjykata vendos pushimin e gjykimit nëse:
 - i. kërkesëpadia duket qartazi si e pabazuar ose
 - ii. kërkesa është e papranueshme, ose
 - iii. paditësi nuk plotëson ose korrigjon formularin e kërkesëpadisë brenda kohës së përcaktuar.

- Gjykata ose tribunali informon paditësin për vendimin e pushimit dhe nëse mund të kryehet apo jo ankim kundër një vendimi të tillë.



- PEPV është një procedurë në parim me shkrim.
 - a. Gjykata ose tribunali do të zhvillojë një seancë gjyqësore me prani të palëve vetëm nëse vlerëson se nuk është e mundur të jepet vendimi në bazë të provave me shkrim ose
 - b. Nëse një palë e kërkon këtë.
- Gjykata ose tribunali mund të refuzojë kërkesën e palës nëse vlerëson se, në lidhje me rrethanat e çështjes, një seancë gjyqësore me prani të palëve nuk është e nevojshme. Arsyet e refuzimit duhet të jepen me shkrim. Ankimi ndaj vendimit të refuzimit nuk mund të ankimohet me ankimin të veçantë por së bashku me vendimin gjyqësor përfundimtar.



- Pasi Gjykata merr formularin e kërkesëpadisë (Forma A), i plotësuar në mënyrë të rregullt, plotëson pjesën I të formularit C (formular për përgjigje standard) (shih Anex III)

- Brenda 14 ditëve nga marrja e Formës A, Gjykata i dërgon të Paditurit (sipas mënyrës së njoftimit parashikuar në nenin 13) :
 - a. Kopje të formularit të kërkesëpadisë (të Formës A);
 - b. Kopje të dokumenteve mbështetëse nëse ka;
 - c. Formularin C, në të cilin është plotësuar vetëm Pjesa I.



- I padituri paraqet përgjigjen e tij brenda 30 ditëve nga dorëzimi i Formës A dhe Formës C (me Pjesën I të plotësuar nga gjykata), shoqëruar, kur është rasti, me dokumente mbështetës.

- Përgjigja mund të jetë:
 - a. Forma C në të cilën është plotësuar Pjesa II;
 - b. Në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme, duke mos përdorur formularin e përgjigjes.



*Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)*



- Brenda 14 ditëve nga marrja e përgjigjes nga i Padituri, gjykata ose tribunal i dërgon paditësit një kopje të saj, së bashku me çdo dokument mbështetës përkatës.
- Nëse, në përgjigjen e tij, i padituri pretendon se vlera e një kërkesëpadie jo-monetare tejkalon 5000Euro, Gjykata ose tribunali shprehet me vendim brenda 30 ditëve nga dërgimi i përgjigjes Paditësit. Ndaj këtij vendimi nuk mund të kryhet ankim i veçantë.



*Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)*



1. Çdo kundërpadi, paraqitet duke përdorur Formularin standard A;
 2. Kundërpadia dhe cdo dokument mbështetës i dorëzohet paditësit në përputhje me nenin 13, brenda 14 ditëve nga data e marrjes.
- Paditësi do të ketë 30 ditë nga njoftimi për t'iu përgjigjur çdo kundërpadie.



- Duhet të dorëzohen në gjuhën ose në një nga gjuhët e gjykatës ose tribunalit:
 - a. Formulari i kërkesëpadisë (A),
 - b. Përgjigjja (B),
 - c. Cdo kundërpadi (A),
 - d. Cdo përgjigje ndaj një kundërpadie (B) dhe
 - e. Cdo përshkrim i dokumenteve mbështetëse

- https://e-justice.europa.eu/content_small_claims-354-ie-en.do?member=1#a_111

- P.sh Irlanda: **Article 25 1 (i) Accepted languages:** English and Irish



- Nëse ndonjë dokument tjetër (përvec Formave) i marrë nga gjykata ose tribunali nuk është në gjuhën në të cilën zhvillohet procedura, gjykata ose tribunali mund të kërkojë përkthim të këtij dokumenti vetëm nëse përkthimi duket të jetë i nevojshëm për dhënien e vendimit.

- Kur një palë refuzon të pranojë një dokument sepse nuk është në asnjë nga gjuhët e mëposhtme:
 - a. gjuha zyrtare e Shtetit Anëtar të adresuar ose nëse ka disa gjuhë zyrtare në atë Shtet Anëtar, gjuha zyrtare ose një nga gjuhët zyrtare të vendit ku do të kryhet njoftimi ose në vendin ku do të dërgohet dokumenti; ose
 - b. një gjuhë të cilën personi i thirrur e kupton,

- Gjykata ose tribunali do të informojë palën tjetër, në mënyrë që ajo palë të sigurojë përkthimin e dokumentit.



- Brenda 30 ditëve nga marrja e Përgjigjes (B) nga I Padituri ose Paditësi, gjykata ose tribunali **do të japë një vendim**, OSE:
 - a. Do të kërkojë detaje të tjera në lidhje me pretendimet e palëve brenda një periudhe të caktuar kohe, jo më shumë se 30 ditë;
 - b. Do të marri prova në përputhje me nenin 9; ose
 - c. Do të thërrasi palët në një seancë dëgjimore që do të mbahet brenda 30 ditëve nga thirrja.
- Nëse thërret seancë dëgjimore, Gjykata ose tribunali do të japë vendimin brenda 30 ditëve nga seanca dëgjimore.
- Nëse kërkon dokumente/informacione, Gjykata ose Tribunali do të jap vendimin brenda 30 ditëve pasi të ketë marrë të gjithë informacionin e nevojshëm për dhënien e vendimit. Vendimi u njoftohet palëve në përputhje me nenin 13.



Gjykimi i padive për shuma të vogla

- Neni 162/a:
- “1. (1) Paditë me vlerë deri në 150 000 lekë, (2) që rrjedhin nga marrëdhënie kontraktore shyrtohen nga gjykata me gjykim të shkurtuar.
- 2. Shqyrtimi i çështjes me gjykim të shkurtuar para gjykatës bëhet me shkrim. Gjykata mund të zhvillojë seancë gjyqësore verbale nëse e cmon të nevojshme. [# me 172/1 KPrC]
- 3. Në lidhje me gjykimet e padive të mësipërme, zbatohen vetëm rregullat e parashikuara në paragrafin e dytë, të nenit 172, neneve 236/a, 285/a, 310, 315, 460 dhe 510 të këtij Kodi. ([jo përjashtuese dhe jo interpretim të ngushtuar, psh n. 154, n. 57/4 psh 472/2 “Nuk lejohet rekurs kundër vendimeve të gjykatës së apelit për paditë me vlerë deri në 150 000 Lekë, ose neni 57/4 “bashkimi i padive)
- 4. Në rast se vlera e padisë është më e vogël se 150 000 lekë dhe vlera e kundërpadisë tejkalon 150 000 lekë, gjykimi zhvillohet sipas dispozitave të përgjithëshme për gjykimin e zakonshëm.”



- Neni 172(2): “Shpjegimet dhe pretendimet me shkrim të paraqitura nga palët, në mbështetje të kërkesave dhe konkluzioneve të tyre, bëhen pjesë e dosjes gjyqësore, ose i bashkohen procesverbalit kur ai mbahet me shtypshkrim apo dorëshkrim.”
- **Dëshmitarët**
- Neni 236/a: “Në shqyrtimin e padive me vlerë deri në 150 000 lekë, gjykata mund të vendosë që dëshmitë e dëshmitarëve të merren me anë të deklaratave me shkrim ose videokonferencës, të siguruara jashtë ambienteve të gjykatës. Në deklaratën me shkrim të dëshmitarit duhet të shënohet paralajmërimi i përgjegjësisë ligjore për deklaram të rremë. Vërtetimi i nënshkrimit vërtetohet nga noteri ose sekretaria e gjykatës.”
[KLGJ të normojë procedurën]



- **Palët:**

- Neni 285/a: “1. Në lidhje me paditë me vlerë deri në 150 000 lekë, gjykata vendos për palët që të sjellin shpjegimet me shkrim ose nëpërmjet videokonferencës.
- 2. Me kërkesë të arsyetuar të palëve, si dhe kur gjykata e cmon të arsyeshme, ato mund të pyeten nëpërmjet mënyrave dhe mjeteve të tjera të komunikimit në distancë.
- 3. Aspektet vizuale dhe zanore të seancës të videokonferencës transmetohen në kohë reale të vendndodhjes me sallën ku zhvillohet procesi gjyqësor.
- 4. Aspektet vizuale dhe zanore të transmetuara nuk regjistrohen. Vendimet e mësipërme janë të paankimueshme.” [duhet ndarë në pikë më vete]



- Vendimi duhet të përmbajë hyrjen, pjesën përshkruese, arsyetuese dhe pjesën urdhëruese.
- I. Në hyrjen e vendimit duhet të përmenden: 1. gjykata që ka gjykuar çështjen, 2. trupi gjykues dhe sekretari, 3. koha dhe vendi i dhënies së vendimit, 4. palët, duke u shënuar identiteti dhe cilësia e tyre si paditës, I paditur, ndërhyrës, si dhe përfaqësuesit e tyre, 5. emri i prokurorit, nëse ka marrë pjesë, 6. objekti i padisë, 7. kërkimet përfundimtare të palëve, 8. mendimi i prokurorit nëse ka marrë pjesë.
- II. Në pjesën përshkruese-arsyetuese duhet të përmenden: 1. rrethanat e çështjes, ashtu siç janë konstatuar gjatë gjykimit dhe përfundimet e nxjerra nga gjykata, 2. provat dhe arsyet në të cilat mbështetet vendimi, 3. dispozitat ligjore në të cilat bazohet vendimi. **Vendimi i gjykatës për paditë me vlerë deri në 150 000 lekë duhet të përmbajë hyrjen dhe pjesën urdhëruese, sipas pikës 1 [dhe pikës III] të këtij neni. Nëse palët, brenda tre ditëve nga njoftimi i këtij vendimi, njoftojnë me shkrim gjykatën se do ta ankimojnë vendimin, gjykata arsyeton vendimin dhe ua njofton palëve.**
- III. Në pjesën urdhëruese, ndër të tjera, duhet të përmenden: 1. çfarë vendosi gjykata, 1/1. Nëse gjykata vendos detyrime për palët, përmbajtjen konkrete të tyre dhe se vendimi është i ekzekutueshëm nga përmbartuesi gjyqësor. 2. kujt i ngarkohen shpenzimet gjyqësore. 3. e drejta për të bërë ankim dhe afati për paraqitjen e tij.



- Neni 315: “Vendimet që jepen gjatë gjykimit dhe që nuk janë përfundimtare, mund të ndryshohen ose të revokohen nga gjykata që i ka dhënë, përvec kur në këtë Kod parashikohet se kundër tyre mund të bëhet ankim i vecantë.”
- Neni 57/4: “Në rastin kur bashkohen padi, të cilat gjykohen sipas rregullave të gjykimit të shkurtuar me padi që gjykohen sipas rregullave të zakonshme, për gjykimin e çështjes zbatohen rregullat e zakonshme.”



*Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)*



FALEMINDERIT!